



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 6.9.2019
(Dokument Parlamentar)

RAPORT

**PËR DEKRETIN NR. 11248, DATË 5.8.2019, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS,
“PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM TË LIGJIT NR. 44/2019 “PËR DISA SHTESA
DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995, ‘KODI PENAL I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË’, TË NDRYSHUAR”**

I. HYRJE

Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 18 korrik 2019 miratoi ligjin Nr.44/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”.

Bazuar në nenin 85 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Presidenti i Republikës ka depozituar pranë Kuvendit, dekretin nr.11248, datë 5.8.2019, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 44/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”.

Bazuar në nenin 26, pika 7, të Rregullores së Kuvendit, ky dekret është përfshirë automatikisht në programin e punës së Kuvendit.

**II. DISKUTIMI I DEKRETIT TË PRESIDENTIT NË KOMISIONIN PËR
ÇËSHTJET LIGJORE**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, bazuar në nenin 86 dhe në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e datës 6 shtator 2019 shqyrtoi dekretin nr.11248, datë 5.8.2019, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 44/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm z. Bledar Dervishaj, përfaqësues i institucionit të Presidentit të Republikës, si dhe Ministria e Drejtësisë znj. Etilda Gjonaj.

Përfaqësuesi i Presidentit të Republikës, paraqiti në mënyrë të përmbledhur argumentet për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr.44/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, si dhe kërkoi nga deputetët miratimin e dekretit.

Ministria e Drejtësisë, znj. Etilda Gjonaj, duke u shprehur kundër dekretit, theksoi në Komision se ndryshimet në Kodin Penal janë të nevojshme pasi kanë për qëllim luftën pa kompromis ndaj kriminalitetit. “Duke pasur në konsideratë që ka pasur mungesë të instrumenteve për të luftuar forma të reja të krimit, janë sjellë këto ndryshime. Ashpërsimi i veprës penale nuk është e vetmja rrugë, por nga nevoja e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, u sollën këto ndryshime” - tha znj. Gjonaj.

Lidhur me çështjet e ngritura në dekretin e Presidentit të Republikës, relatorja e ligjit, znj. Elena Xhina paraqiti argumentet dhe vlerësimet për çështjet e ngritura në dekretin e Presidentit.

Në vazhdim të diskutimit, anëtarët e Komisionit paraqitën opinionin e tyre lidhur me argumentet e paraqitura nga Presidenti i Republikës në Dekretin për kthimin për rishqyrtim të ligjit Nr.44/2019.

III. ARSYET E KTHIMIT TË LIGJIT NR.44/2019

Presidenti i Republikës çmon se ligji Nr.44/2019 në përgjithësi është një akt ligjor me tendencë pozitive, pasi për disa çështje, dispozitat aktuale të Kodit Penal nuk garantojnë parandalimin apo ndëshkimin e duhur të disa veprimeve apo mosveprimeve negative që janë shfaqur në shoqëri, për të cilat është e nevojshme parashikimi i tyre si vepra penale, apo për disa prej tyre është vlerësuar se nevojitet forcimi i ndëshkimit penal.

Presidenti ktheu për rishqyrtim ligjin me qëllim që të rishqyrtohen nenet 3, 6, 7 dhe 11 të ligjit. Sipas relacionit që shoqëron dekretin, nga shqyrtimi i ligjit nr. 44/2019 konstatohet se formulimet e disa dispozitave të neneve të mësipërme përmbajnë problematika që cenojnë parimin e efektivitetit të normës, duke rrezikuar aplikimin dhe interpretimin në praktikë të tyre, për shkak të mungesës së qartësisë, çka do të kërkonte shumë shpejt ose amendim të tyre, ose do të bënte të nevojshme sqarimin e tyre nga jurisprudenca.

IV. LIDHUR ME PËRMBAJTJEN E NENIT 3 TË LIGJIT NR. 44/2019 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995, ‘KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË’, TË NDRYSHUAR”

Neni 3 i ligjit 44/2019, i cili synon ndryshimin e nenit 121 të Kodit Penal, sipas argumenteve të paraqitura në Dekretin e Presidentit krijon mbivendosje me dispozitat të tjera Kodit Penal dhe nuk është në harmoni me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale.

Në nenin 3 të ligjit 44/2019, parashikohet ndryshimi i nenit 121, me këtë formulim:

“Neni 121

Ndërhyrje të padrejta në jetën private

Vendosja e aparaturave që shërbejnë për dëgjim apo regjistrim të fjalëve ose të figurave, dëgjimi ose regjistrimi i fjalëve, fiksimi ose regjistrimi i figurave, si dhe ruajtja për publikim i të dhënave që ekspozojnë një aspekt të jetës private të personit, pa pëlqimin e tij, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Shpërndarja, ofrimi për publikim apo publikimi me çdo mjet ose formë të komunikimit publik apo mënyrë tjetër i të dhënave të marra në mënyrën e përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Po kjo veprë, kur kryhet ndaj personave të mitur, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik apo nga personi që disponon këto të dhëna për shkak të detyrës shtetërore apo shërbimit publik, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet”.

Në Dekretin e Presidentit, në veçanti është analizuar paragrafi i katërt i nenit 121, që ka përcaktuar rrethanat cilësuese të kryerjes së veprës, posaçërisht subjektin e veprës penale, pra funksionarin shtetëror apo në shërbimin publik, që për shkak të këtij funksioni ose nëpërmjet shfrytëzimit të këtij funksioni, mund të konsumojë elementë të veprës penale të parashikuar.

Sipas analizës së paraqitur në dekret, ky paragraf i katërt i këtij formulimi të ri ligjor, kërkon më shumë qartësi në lidhje me subjektin e veprës penale. Gjithashtu, në dekret është vlerësuar se ky paragraf duhet riformuluar dhe qartësuar, edhe nën dritën e faktit se duhet bërë një dallim edhe më i fortë me subjektin e veprës penale sipas parashikimeve të këtij neni të sapomiraturuar, me atë të nenit pasardhës, (neni 122), i cili nënkupton një kategori tjetër funksionarësh shtetërorë apo publikë, që për shkak të detyrës disponojnë këto të dhëna.

Lidhur me çështjet e paraqitura më sipër nga Presidenti i Republikës, nga argumentet e paraqitura nga relatorja, si dhe nga diskutimet në Komision, u vlerësua se ligjvënësi, në ndryshimin e kësaj dispozite ka vlerësuar si parësore dhe të rëndësishme mbrojtjen efektive të të drejtës së jetës private si dhe parandalimin e fenomenit të shantazhit ndaj individëve, për qëllime të ndryshme. Ky ndryshim ka ardhur si domosdoshmëri në kushtet kur zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe përdorimi masiv i rrjeteve sociale kanë mundësuar mënyra të shumta për

cenimin e jetës private të individëve. Duke u nisur nga disa raste të bëra publike në media kohët e fundit, mbi abuzimin që është bërë në publikimin e të dhënave private që kanë prekur në veçanti gra dhe të mitur, nga deputetët erdhi propozimi për një rishikim të nenit 121, me qëllim ashpërsimin e sanksioneve ndaj atyre që abuzojnë dhe shantazhojnë me këto të dhëna.

Për sa i përket argumentit të paraqitur nga Presidenti se duhet një dallim edhe më i fortë me subjektin e veprës penale sipas parashikimeve të paragrafit të katërt të nenit të sapomiraturar, me atë të nenit pasardhës (neni 122), i cili nënkupton një kategori tjetër funksionarësh shtetërorë apo publikë, që për shkak të detyrës disponojnë këto të dhëna, relatorja tërhoqi vëmendjen se nëse do të lexohen më kujdes dy nenet, është qartësisht e dukshme që në secilin nen kemi të bëjmë me figura të ndryshme penale. Në nenin 121, subjekti i posaçëm, është personi që ushtron funksione shtetërore ose shërbime publike, apo personi që disponon të dhëna për shkak të funksionit apo shërbimit publik, i cili nëpërmjet shfrytëzimit të këtyre funksioneve konsumon një nga format e kryerjes së veprës penale si vendosja e aparaturave që shërbejnë për dëgjim apo regjistrim të fjalëve ose të figurave, dëgjimin ose regjistrimin e fjalëve, dhe publikimin e të dhënave, **jo si pjesë të detyrave të tij funksionale**, por me iniciativën e tij, duke shfrytëzuar mundësitë që i jep pozicioni i tij.

Në nenin 122 aktual të Kodit Penal, bëhet fjalë për ato të dhëna që funksionari publik i siguron gjatë ushtrimit të detyrës, për të cilat ka detyrimin që t'i ruajë, por që me qëllim përfitimi apo për të dëmtuar dikë i keqpërdor.

Nga ana tjetër, në këto parashikime ajo që bën dallimin kryesor është ana objektive. Në nenin 121 ana objektive e figurës së veprës penale përbëhet nga vendosja e aparaturave që shërbejnë për regjistrim, dëgjimi e fiksimi i aspekteve të ndryshme të jetës private, ruajtja apo publikimi i këtyre të dhënave si dhe shpërndarja në çdo formë e të dhënave të përfutuara në këtë formë të paligjshme.

Ndërsa në nenin 122 të Kodit Penal në fuqi, ana objektive përbëhet nga përhapja e një sekreti të jetës private, pra një aspekt krejt tjetër dhe i ndryshëm nga vendosja e aparaturave për regjistrim, pa dijeninë e personit të dëmtuar. Subjekti i veprës penale të parashikuar në nenin 122 i ka përfutur sekretet vetjake në mënyrë të ligjshme, me vullnetin e lirë të personit të dëmtuar nga vepra penale, dhe në asnjë rrethanë dhe kurrsesi nuk mund të konfondohej me subjektin e posaçëm të parashikuar në paragrafin e katërt të nenit 121.

I njëjti qëndrim vlen edhe për argumentin e paraqitur në dekret se disponimet e nenit 248 të Kodit Penal, që parashikon shpërdorimin e detyrës shtetërore nëpërmjet shkeljes së ligjit dhe me pasoja të rënda ligjore për shtetin dhe shtetasit, janë të mjaftueshme për të trajtuar këto raste. Edhe në nenin 248 parashikohen rastet e mospërbushjes së rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, por në dallim nga neni 121 i ndryshuar, sipas të cilit funksionari e kryen veprën penale kur është duke vepruar jashtë detyrës dhe funksioneve që i njeh ligji, neni 248 i Kodit Penal kërkon si element të figurës së veprës penale përfitime materiale ose jomateriale të padrejta, duke shpërdoruar detyrën që lidhet drejtpërdrejt me subjektin e veprës penale.

Nga ana tjetër, vepra penale e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal ka si objekt të saj mbrojtjen e veprimtarisë shtetërore të kryer nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, ndërsa vepra penale e parashikuar nga neni 121 ka si objekt të saj mbrojtjen e marrëdhënieve juridike që sigurojnë paprekshmërinë e moralit dhe dinjitetin e personit. Nëse do të ndiqnim këtë arsyetim, që mjafton aplikimi i nenit 248, atëherë dhe neni 122 ekzistues i Kodit Penal, do të ishte i panevojshëm. Sa më sipër, figura e veprës penale parashikuar nga neni 121 i Kodit Penal, nuk konkurren me figurën e krimit të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i tij.

Gjithashtu, në përgjigje të rezervave që shpreh presidenti në dekretin e tij për konkurrimin e dispozitave, në mungesë dhe të interpretimit nga Gjykata e Lartë, theksojmë se Gjykata e Lartë ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar në vite për unifikimin e praktikës gjyqësore për çështjet penale.

Për sa i takon shqetësimin të ngritur se paragrafi i katërt i dispozitës, i cili përcakton subjektin e posaçëm, duhet të të ripozicionohet si vepër penale në kreun ku janë renditur veprat penale të kryera nga subjektet e posaçme - punonjës shtetërorë, tërheqim vëmendjen dhe njëherë se në nenin 121 i cili kërkon të ndryshohet, objekti i figurës së veprës penale është mbrojtja e jetës private të personit dhe fakti që parashikohet një subjekt i posaçëm nuk e largon vëmendjen nga qëllimi i dispozitës, përkundrazi i siguron një mbrojtje më efektive jetës private. Si shembull është neni 128/b, paragrafi i 5 i Kodit Penal ekzistues, i cili parashikon subjekt të posaçëm dhe si objekt të tij ka mbrojtjen e fëmijëve, familjes dhe martesës.

Së fundi, në dekret ngrihet shqetësimi se paragrafi i katërt i nenit 121 është i paqartë pasi nuk përcaktohet qartë se për cilën nga veprimet mban përgjegjësi subjekti i posaçëm, për ato të parashikuara në paragrafin e parë apo të dytë.

Lidhur me këtë shqetësim, sqarojmë se vepra penale e parashikuar nga neni 121, nga ana objektive parashikon disa forma të kryerjes së saj, për të garantuar një mbrojtje të plotë të jetës private. Mënyra e kryerjes së veprës penale, është çmuar të cilësohet nga ligjvënësi duke ndarë veprimet e kryera në dy paragrafë, sipas rrezikshmërisë së tyre. Në këto kushte, të dy paragrafët, si i pari dhe i dyti, si veç e veç por dhe të kryera së bashku, përbëjnë të njëjtën vepër penale, dhe si rrjedhojë formulimi i paragrafit 4 të nenit 121 "*Kur vepra kryhet nëpërmjet...*", nuk lë asnjë vend për keqkuptim, pasi është e qartë që bëhet fjalë për veprën penale të parashikuar nga neni 121 dhe më pas mbetet detyrë e organit të hetimit të përcaktojë anën objektive të kryerjes së veprës.

Ndërsa në lidhje me sugjerimin që pas ndryshimit të nenit 121, është i nevojshëm edhe ndryshimi i nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, me titull "Viktima akuzuese", vlerësojmë se një ndryshim i tillë nuk është i nevojshëm. Pavarësisht rritjes së rrezikshmërisë dhe ashpërsimit të sanksioneve në nenin 121 të Kodit Penal, për shkak të natyrës së shkeljes dhe sensibilitetit që mund të ketë, është vetë personi i dëmtuar ai që mund të vendosë nëse do t'i drejtohet apo jo gjykatës. Gjithashtu edhe masa e dënimit nuk është përcaktuese në këto raste, sillet si shembull

këtu që personi i dëmtuar mund të ngrejë akuzë edhe për veprën e parashikuar në nenin 254 të Kodit Penal, që ka si masë dënimi deri në 5 vjet burgim.

V. LIDHUR ME PËRMBAJTJEN E NENIT 6 TË LIGJIT NR.44/2019

Presidenti është shprehur në dekret se neni 6 i ligjit nr. 44/2019, i cili ndryshon nenin 201 të Kodit Penal, në paragrafët 2-5 përmban shprehje abstrakte, përdorimi i të cilave jo vetëm e bën të pamundur zbatimin këtyre paragrafëve në praktikë, por krijon rrezik që të sjellë një precedent në ushtrimin e ndjekjes penale apo dhënien e dënimeve në mënyrë jo proporcionale. Sipas dekretit, lënia e hapësirave abstraguese në dispozitë dhe formulimi jo i saktë sa i takon teknikës legjislativë është një mundësi e hapur për keqinterpretim dhe abuzim në praktikë.

Neni 6 i ligjit, që ndryshon nenin 201 të Kodit Penal, përcakton ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, si vepra penale me rrezikshmëri të lartë dhe për të cilat ashpërsohen sanksionet. Ndryshimet në nenin 201 të Kodit Penal, si dhe shtesa e disa neneve të reja në këtë Kod, theksoi relatorja, kanë si qëllim mbrojtjen e mjedisit nga veprime të kryera nga persona fizikë a juridikë, me dashje apo nga pakujdesia, të cilat bien ndesh me legjislacionin specifik për mjedisin dhe që rrezikojnë të shkaktojnë dëm real mbi cilësinë e ajrit, ujit, tokës, bimët, kafshët, shëndetin apo jetën e njeriut. Këto nene janë propozuar dhe miratuar në përputhje me kërkesat e Direktivës 2008/99/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 19 Nëntor 2008 “Për mbrojtjen e mjedisit përmes legjislacionit penal”. Edhe terminologjia e përdorur në këto nene, ka respektuar terminologjinë teknike të direktivës, por duke ruajtur edhe përputhshmërinë me strukturën dhe gjuhën e përdorur në Kodin Penal.

Për sa i përket rezervës që shpreh presidenti në dekretin e tij, se rrethana e cilësuar e kryerjes së veprës penale, që sjell si rezultat rritjen e masës së dënimit rezulton të jetë përcaktuar me shprehje të papërshtatshme për qëllimin për të cilin këto dispozita janë hartuar, vlerësohet se:

-Elementi “i lidhjes shkaksore” të veprës penale të parashikuar në nenin 6 të ligjit (neni 201 i Kodit Penal), duke përdorur togfjalëshin ”ka mundësi të shkaktojë” është në linjë me elementin ”e lidhjes shkakësore” të parashikuar në nenin 3, shkronja “a” të Direktivës së BE-së, sipas të cilës vepra penale kryhet jovetëm kur “ka shkaktuar” dëme (kur ka ardhur pasoja), por edhe kur “mund të shkaktojë” dëme (kur është krijuar mundësia e ardhjes së pasojave).

Gjithashtu formulimi në këtë nen duke parashikuar elementin e lidhjes shkakësore është në përputhje edhe me nenin 13 të Kodit Penal “Lidhja shkakësore” që parashikon se:

”Askush nuk ka përgjegjësi penale kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave apo mundësisë së ardhjes së tyre, mungon lidhja shkakësore”.

Së fundi, lidhur me elementin e lidhjes shkakësore të veprave penale, ky formulim është përdorur dhe në dispozita të tjera aktuale të Kodit Penal. Konkretisht, neni 230 i Kodit Penal “Vepra me qëllime terroriste” parashikon si element të lidhjes shkakësore të veprës kësaj penale, jo vetëm rastet kur “kanë ardhur pasojat”, por edhe rastet “kur është krijuar mundësia e ardhjes së pasojave” (“veprat kundër personit, të cilat mund të shkaktojnë vdekjen ose plagosjen e rëndë;” neni 230 i Kodit Penal).

VI. LIDHUR ME PËRMBAJTJEN E NENIT 7 TË LIGJIT NR.44/2019

Presidenti në dekretin e tij është shprehur se Neni 7 i ligjit 44/2019, i cili parashikon shtimin e një figure të re të veprës penale, atë të transportimit të mbetjeve, është i paqartë në mënyrën se si është miratuar dhe e bën aplikimin e kësaj dispozite të vështirë nga ana praktike.

Sipas dekretit, duhen evituar shprehje “*në sasi të papërfillshme*” dhe “*ndikim të papërfillshëm*”, sepse janë parashikime ligjore që nuk diktojnë masën e saktë të anës objektive të veprës penale,

Lidhur me sa është paraqitur më sipër në dekret, relatorja sqaroi se, ashtu si dhe në rastin e nenit 6 të ligjit, edhe neni 7 është propozuar dhe miratuar në përputhje me kërkesat e Direktivës 2008/99/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 19 Nëntor 2008 “Për mbrojtjen e mjedisit përmes legjislacionit penal”. Edhe terminologjia e përdorur në këtë nen, ka respektuar terminologjinë teknike të direktivës. Nga ana tjetër, nga leximi i dispozitave, 201/b, 202 dhe 202/a rezulton se dispozita referon në ligjin specifik, i cili sqaron qartësisht në secilin rast se cila është “sasi të papërfillshme”, dhe çfarë është “ndikimi i papërfillshëm”.

Për sa i përket shqetësimit të ngritur se këto vepra nuk përcaktojnë rrethana të cilësuar si bashkëpunimi apo përsëritja e saj, këto kërkesa i plotëson më së miri pjesa e përgjithshme e Kodit Penal, dhe konkretisht neni 50, shkronjat “gj” dhe “h”.

VII. LIDHUR ME PËRMBAJTJEN E NENIT 11 TË LIGJIT NR.44/2019

Sipas dekretit, në nenin 11 të ligjit 44/2019, ku parashikohet shtimi i nenit 207/a dhe sanksionohet si vepër penale braktisja e kafshës së shoqërimit, nuk rezulton të jetë përcaktuar subjekti i veprës penale dhe formulimi i saj paraqet paqartësi që vështirësojnë aplikimin e saj në praktikë.

Lidhur me sa më sipër relatorja sqaroi se ligjvënësi në hartimin e dispozitës ka pasur si qëllim përcaktimin e anës objektive të veprës, si dhe pasojat që vijnë prej saj në mjediset publike apo të hapura për publikun. Për sa i përket përcaktimit të subjektit të veprës, bëhet nga organet ligjzbatuese, sipas rastit, bazuar edhe në legjislacionin e posaçëm i cili përcakton në mënyrë të detajuar subjektet përgjegjëse për mbajtjen e kafshëve.

Mospërcaktimi i subjektit të veprës penale vihet re edhe në mjaft nene të tjera të Kodit Penal, por kjo nuk përbën shkak për moszbatimin apo për paqartësi të këtyre neneve.

Lidhur me shqetësimin e ngritur se kjo dispozitë nuk parashikon rastin kur plagosja e rëndë nga kafsha ndodh në banesën e pronarit të kafshës, sipas relatores, qëllimi i dispozitës është të rregullojë vetëm rastet e braktisjes së kafshës apo mosvendosjes së maskës së shoqërimit në ambientet publike dhe në rastet kur ajo sjell pasoja për shëndetin e njerëzve

Në përfundim, duke vlerësuar se argumentet e paraqitura në Dekretin nr.11248, datë 5.8.2019, të Presidentit të Republikës, nuk kanë asnjë bazë kushtetuese, dhe duke vlerësuar se nenet e kontestuara janë hartuar qartë dhe në përputhje harmonike me gjithë dispozitat e tjera të Kodit Penal, relatorja ftoi anëtarët e Komisionit që të votojnë kundër Dekretit të Presidentit.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, vendosi rrëzimin e Dekretit të Presidentit të Republikës, nr.11248, datë 5.8.2019, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 44/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, dhe ia përcjell për votim seancës plenare.

RELATORE

Elena XHINA

KRYETARI

Ulsi MANJA